

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA PËR POLITIKË MONETARE DHE HULUMTIM



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikimi i gjendjes aktuale

dhjetor 2024

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimet ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (shtator - nëntor 2024) dhe krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (tetor 2024). Me këtë do të përcaktohet se sa korrespondon gjendja aktuale e ekonomisë me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është fokusuar në ndryshimet e supozimeve dhe realizimeve të jashtme të variablave në vend dhe mënyrën se si këto ndryshime janë reflektuar në mjedisin e zhvillimit të politikës monetare.

Sipas vëzhgimeve të fundit, për periudhën 2024 – 2026 pritet rritje e qëndrueshme globale¹, ndërsa vlerësimet për këtë dhe vitin e ardhshëm janë të pandryshuara në krahasim me pritjet e vjeshtës. Rreziqet që lidhen me rritjen globale janë kryesisht në rënie, ndërsa rreziku i rritjes së tensioneve gjeopolitike dhe pasigurisë në politikat tregtare është më i rëndësishmi në afat të shkurtër, gjë që mund të reflektohet në reduktimin e ofertës së produkteve parësore dhe rritje të mëtejshme të barrierave tregtare, që do të sillte rritjen e çmimeve të importeve dhe të inflacionit dhe rënien e besimit. Në të njëjtën kohë, rritja më e dobët ose ngadalësimi më i ngadalshëm i inflacionit mund të shkaktojë paqëndrueshmëri në tregjet financiare dhe ta rrezikojë stabilitetin financiar, si dhe ta rrisë cenueshmërinë financiare, veçanërisht të vendeve në zhvillim me borxhe të larta. Një rrezik shtesë është rritja e sektorit financiar jobankar, i cili është i rregulluar më dobët, si dhe mundësia e transferimit të shpejtë të goditjeve të mundshme në këtë segment në segmentet e tjera të tregut. Rritja e mundshme më e dobët se sa pritej në Kinë edhe më tej mbetet si rrezik. Nga ana tjetër, si rreziqe pozitive për rritjen përmenden ulja e shpejtë e përshkallëzimit të konflikteve aktuale gjeopolitike, ulja më e fuqishme e normave të kursimit të popullsisë, si dhe goditjet e mundshme pozitive në anën e ofertës (rritje më e fuqishme e fuqisë punëtore ose e investimeve private sesa pritej), të cilat mund ta rrisin potencialin ekonomik të ekonomisë globale.

E parë përmes treguesve të veçantë sasiorë për mjedisin e jashtëm, të rëndësishëm për ekonominë maqedonase, vlerësimet për rritjen e kërkesës së huaj efektive dhe inflacionit të jashtëm efektiv për periudhën e viteve 2024-2026 janë rishikuar minimalisht në rënie krahasuar me projeksionet e tetorit. Për sa i përket kursit të këmbimit euro/dollar amerikan, pritet zhvlerësim më i vogël i dollarit amerikan krahasuar me muajin tetor për të gjithë periudhën e projeksionit. Rishikimet në **çmimet botërore të produkteve primare** për vitet 2024 dhe 2025 janë kryesisht në rënie dhe për vitin 2026 janë të ngjashme me muajin tetor, ku çmimet pritet të bien kryesisht në vitet 2024 dhe 2025 dhe të stabilizohen në vitin 2026. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të mallrave vazhdojnë të ndikohen fuqishëm nga zhvillimet që lidhen me luftën në Ukrainë dhe konfliktin ushtarak në Lindjen e Mesme, gjë që krijon pasiguri të madhe për dinamikën dhe efektet e tyre në të ardhmen në ekonominë globale dhe vendase.

Për sa i përket **normës së interesit të huaj EURIBOR** me afat maturimi njëmuor, pritet ulje e saj gjatë gjithë periudhës së projeksionit, minimalisht më e fuqishme krahasuar me muajin tetor. Në mbledhjen e dhjetorit, BQE-ja i uli normat e interesit me 0.25 p.p. për herë të katërt këtë vit (ose me 1 p.p. në total), me vlerësim për rimëkëmbje më të dobët të aktivitetit ekonomik në Eurozonë sesa pritej dhe ngadalësim të mëtejshëm të inflacionit të përgjithshëm në përputhje me pritjet. Kështu, në lidhje me inflacionin, BQE-ja në projeksionet e saj të dhjetorit bëri korrigjime minimale në rënie për këtë vit dhe për vitin e ardhshëm në krahasim me shtatorin², kështu që tani pritet të jetë përkatësisht 2.4% dhe 2.1% në vitet 2024 dhe 2025 dhe përkatësisht me 1.9% dhe

¹ Sipas raportit të OECD-së "Rishikim ekonomik", dhjetor 2024.

² Në shtator, normat e inflacionit u projektuan në 2.5% në vitin 2024, 2.2% në vitin 2025 dhe 1.9% në vitin 2026.

2.1% në vitet 2026 dhe 2027, ndërkohë që vlerësimet për rritjen ekonomike janë rishikuar lehtësisht në rënie dhe është parashikuar rritje prej 0.7% në vitin 2024, që do të rritet përkatësisht³ me 1.1%, 1.4% dhe 1.3% në vitet 2025, 2026 dhe 2027.

Treguesit e fundit nga ekonomia vendase flasin për pamje makroekonomike që nuk devijon shumë nga parashikimet e tetorit. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, **rritja reale vjetore e PBB-së u përshpejtua pak dhe arriti në 3%** (rritje prej 2.8% në tremujorin e mëparshëm), me rritje të mëtejshme edhe në bazë tremujore (sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së). Norma e arritur është afër vlerësimit të rritjes vjetore në tremujorin e tretë të tetorit (2.8%). E analizuar sipas komponentëve, rritja vjetore rezulton nga kërkesa e brendshme, brenda së cilës kontributin më të madh e ka konsumi i shtetit dhe i popullsisë, ndërsa rritje të vogël shënojnë investimet bruto. Kontribut të vogël negativ ka dhënë eksporti-neto, me nivele thuajse të pandryshuara të eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve. Të dhënat me frekuencë të lartë për tremujorin e katërt të vitit 2024 aktualisht janë të kufizuara. Për momentin, të dhënat e muajit tetor tregojnë rritje reale vjetore të qarkullimit në totalin e tregtisë, por më e ulët në krahasim me tremujorin e mëparshëm, ndërsa prodhimi industrial ka shënuar rënie më të vogël në krahasim me tremujorin e mëparshëm. **Në nëntor të vitit 2024, norma vjetore e inflacionit u përshpejtua dhe arriti në 4.3%** (3.5% në tetor), duke e marrë parasysh bazën më të ulët krahasuese nga viti i kaluar kur ishin në fuqi masat për kufizimin e përkohshëm të rritjes së çmimeve. Kjo lëvizje ishte e pritshme, kështu që norma e inflacionit të realizuar është në përputhje me normën e parashikuar nga projeksionet e tetorit. Në të njëjtën kohë, norma vjetore rrjedh kryesisht nga komponenti bazë i inflacionit, ndërsa përshpejtimi i rritjes së çmimeve vjen si pasojë e rritjes më të fuqishme të çmimeve të ushqimeve dhe rënies më të dobët të çmimeve të lëndëve djegëse, me rritje më të ngadaltë të inflacionit bazë. Sipas anketës së nëntorit, **pritjet e konsumatorëve** për lëvizjet e çmimeve në periudhën e ardhshme vazhdojnë të tregojnë ulje të çmimeve. Sipas të dhënave të tetorit, **diferenca në raport me inflacionin në Eurozonë** është zgjeruar në mënyrë të moderuar, në kushte të përshpejtitimit më të fuqishëm të inflacionit në vend sesa ai në eurozonë. Rishikimet për sa i përket çmimeve të importit janë kryesisht në rënie, por ende ekziston pasiguria lidhur me dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike.

Rezervat valutore në fund të nëntorit të vitit 2024 arrijnë në 4,920 milionë euro. Analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore, tregon se ato vazhdojnë të mbahen në zonën e sigurt. Të dhënat për shkëmbimin në tregtinë e jashtme në tetor të vitit 2024 tregojnë aktualisht një deficit tregtar për tremujorin e katërt të vitit, i cili është më i ulët se sa pritej sipas projeksionit të tetorit. Të dhënat për operacionet e këmbimit në fund të nëntorit të vitit 2024 tregojnë për flukse hyrëse-neto nga transfertat private, të cilat janë në përputhje me pritjet për tremujorin e katërt me projeksionin e tetorit. Suficiti i realizuar në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në tremujorin e tretë të vitit 2024 është pothuajse në nivelin e parashikuar me projeksionin e tetorit, me dalje financiare-neto të realizuara në përputhje me pritjet.

Sa i përket **lëvizjeve në sektorin monetar**, totali i **depozitave** në tetor të vitit 2024 është më i lartë me 10.7% në bazë vjetore, me rritje të parashikuar vjetore për tremujorin e katërt prej 7.9% sipas projeksionit të tetorit. **Totali i kredive** për sektorin privat në tetor të vitit 2024 është më i lartë me 9.2%, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e katërt prej 7.5% sipas projeksionit të tetorit. Të dhënat e anketës për aktivitetin kreditor për tremujorin e tretë të vitit 2024 tregojnë për lehtësim të caktuar të kushteve për ofertën e kredisë në të dy sektorët, ngjashëm me tremujorin e mëparshëm, kur kërkesa rritet. Shtimi i kredive të reja të miratuara ka ardhur në rritje që nga fillimi i vitit, si rezultat i të dy sektorëve (ndërmarrjeve dhe amvisërive). Konkretisht, shuma e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, përfshirë muajin tetor, mesatarisht ka shënuar rritje vjetore.


³ Sipas projeksionit të shtatorit të vitit 2024, rritja e parashikuar e aktivitetit ekonomik ishte 0.8% në vitin 2024, përkatësisht 1.3% dhe 1.5% në vitet 2025 dhe 2026.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar - tetor të vitit 2024 është realizuar deficit prej 24.012 milionë denarë, ose 53,8% nga deficiti i planifikuar për vitin 2024 (sipas rebalancit buxhetor nga gushti i vitit 2024). Deficiti buxhetor financohet nga huamarrja-neto e shtetit në tregjet e brendshme dhe të jashtme, me rritje të njëkohshme të depozitave të shtetit në Bankën Popullore.

Treguesit kryesorë makroekonomikë janë përgjithësisht në përputhje me pritshmëritë e projeksioneve të fundit. Norma vjetore e inflacionit në muajin nëntor u përshpejtua mesatarisht, por lëvizja është në përputhje me pritjet dhe në nivel të projeksionit. Rreziqet për realizimin e projeksionit të inflacionit për këtë vit vlerësohen të balancuara, duke i marrë parasysh arritjet e deritanishme në inflacion dhe pritshmëritë për çmimet e importeve deri në fund të vitit, të cilat janë shumë pranë projeksioneve të tetorit. Në anketat e fundit të Komisionit Evropian, ende mbizotërojnë pritshmëritë e konsumatorëve për ulje çmimesh në periudhën e ardhshme. Rritja e ekonomisë vendase në tremujorin e tretë të vitit 2024 u përshpejtua pak dhe është afër asaj të projektuar, ndërsa të dhënat e disponueshme për tremujorin e katërt të vitit 2024 janë të kufizuara, por tani për tani tregojnë për tendenca më të favorshme në industri dhe disi më pak të favorshme në tregti. Tregu valutor është ende i qëndrueshëm dhe lëvizjet janë të favorshme, që kontribuoi në blerje të konsiderueshme neto të valutës nga Banka Popullore që nga fillimi i vitit dhe në rritjen e rezervave valutore, me hyrje të qëndrueshme të valutës edhe në tregun valutor. Lëvizjet në depozita dhe kredi tani për tani janë më të mira se sa pritej për tremujorin e fundit të vitit.

Tregues të përzgjedhur makroekonomik / 1								2023																2024															
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	korr.	gush.	sht.	tr-3	tet.	nën.	dhj.	tr-4	2023	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr-2	korr.	gush.	sht.	tr-3	tet.	nën.	
I. Treguesit e sektorit real																																							
Produkti bruto i brendshëm (ritja reale vjetore) ^{/2}	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	4.5	2.8				0.2				2.0				2.7				3.1	2.1				1.9				2.8				3.0			
Prodhimi industrial ^{/3}																																							
norma e ndryshimit (vjetore)	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.6	1.5	-0.2	-2.4	0.9	1.3	0.1	-1.8	6.1	3.7	2.7	-1.8	-5.0	4.5	-0.7	9.9	-2.4	-5.8	0.4	0.6	2.9	0.3	-10.5	-3.0	-1.2	-13.2	-6.5	-7.1	3.8	-1.6	-7.9	-2.1	-1.1		
norma mesatare kumulative	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.6	1.5	-0.2	-2.4	-0.6	0.1	0.1	-0.4	1.0	1.4	1.4	1.0	0.2	0.7	0.7	1.7	1.3	0.6	0.6	0.6	2.9	1.5	-3.0	-3.0	-2.6	-4.9	-5.2	-5.2	-3.9	-3.6	-4.2	-4.2	-3.8		
Inflacioni ^{/4}																																							
CPI inflacioni (vjetore) ^{/5}	-0.2	2.4	0.9	0.4	2.3	4.9	18.7	17.1	16.7	14.7	16.1	13.0	11.3	9.3	11.2	8.4	8.3	6.6	7.7	3.5	3.1	3.6	3.4	3.6	3.2	3.0	4.0	3.4	4.0	4.5	3.2	3.9	3.0	2.2	2.6	2.6	3.5	4.3	
CPI inflacioni (mesatare kumulative)	-0.2	1.4	1.5	0.8	1.2	3.2	14.7	17.1	16.9	16.1	16.1	15.3	14.5	13.6	13.6	12.8	12.2	11.5	11.5	10.7	9.9	9.4	9.4	9.4	3.2	3.1	3.4	3.4	3.6	3.8	3.7	3.7	3.6	3.4	3.3	3.3	3.4	3.4	
Inflacioni bazë (mesatare kumulative)	1.3	2.3	1.5	0.5	0.9	2.4	7.1	10.8	10.6	10.2	10.2	10.2	9.9	9.6	9.6	9.3	9.0	8.7	8.7	8.5	8.2	8.0	8.0	8.0	5.1	4.9	5.0	5.0	4.7	4.9	4.9	4.9	5.0	5.0	5.1	5.1	5.2	5.2	
Inflacioni bazë (vjetore) ^{/5}	1.0	2.8	1.4	-0.3	1.9	2.9	10.8	10.8	10.4	9.5	10.2	10.1	8.9	8.2	9.1	7.4	7.1	6.3	7.0	6.2	6.2	5.4	5.9	5.5	5.1	4.7	5.1	5.0	4.1	5.5	4.7	4.8	5.6	5.3	5.5	5.5	5.9	5.4	
Fuqia punëtore																																							
Norma e papunësisë ^{/11}	23.7	22.3	20.6	17.1	16.2	15.4	14.4				13.3				13.1				12.8				13.0	13.1				12.9				12.5				12.3			
II. Treguesit e sektorit fiskal																																							
(Buxheti qendror dhe Buxheti i fondeve)																																							
Gjithsej të hyrat buxhetore	169,356	179,673	188,505	203,822	189,554	218,021	243,085	19,268	18,749	27,991	66,009	21,207	22,294	21,639	65,140	22,594	22,005	21,728	66,326	26,865	24,128	28,660	79,652	277,127	21,447	23,193	24,778	69,418	28,889	23,746	22,245	74,880	28,748	24,342	25,183	78,273	28,563		
Gjithsej shpenzimet buxhetore	185,407	196,561	200,071	217,445	243,421	256,906	278,596	20,681	23,003	25,849	69,533	30,183	24,814	30,202	85,199	26,070	22,007	22,249	70,326	24,370	27,518	41,628	93,516	318,574	26,919	28,896	28,258	84,073	28,633	31,381	24,054	84,068	26,644	26,237	26,682	79,563	27,442		
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja) ^{/1}	-16,051	-16,888	-11,566	-13,623	-53,867	-38,885	-35,511	-1,413	-4,254	2,142	-3,524	-8,976	-2,520	-8,563	-20,059	-3,477	-3	-521	-4,000	2,495	-3,390	-12,968	-13,864	-41,447	-5,472	-5,703	-3,480	-14,655	256	-7,635	-1,809	-9,188	2,104	-1,895	-1,499	-12,900	1,121		
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja) ^{/1}	-2.7	-2.7	-1.8	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-0.2	-0.5	0.2	-0.4	-1.0	-0.3	-1.0	-2.2	-0.4	0.0	-0.1	-0.4	0.3	-0.4	-1.4	-1.5	-4.6	-0.6	-0.6	-0.4	-1.6	0.0	-0.9	-0.2	-1.0	0.2	-0.2	-0.1	0.1	0.1		
III. Treguesit financiar ^{/6}																																							
Paraja e gjerë (M4), norma vjetore e rritjes	6.2	5.1	11.8	9.3	6.9	7.0	5.1	4.5	5.7	6.9	6.9	8.6	10.5	11.4	11.4	10.6	9.8	8.8	8.8	8.3	7.4	8.7	8.7	8.7	10.0	9.5	9.5	9.5	9.5	9.3	8.5	7.6	7.6	7.6	9.2	8.6	8.6	10.7	
Totali i kredive, norma vjetore e rritjes	-0.1	5.4	7.3	6.0	4.7	8.3	9.4	8.5	7.7	6.6	6.6	6.3	6.5	6.5	6.5	5.8	6.4	5.8	5.8	5.8	5.3	5.2	5.1	5.1	5.1	5.7	6.5	6.1	6.1	6.8	6.8	6.4	7.3	7.5	7.5	7.5	9.2		
Totali i kredive të popullsisë	7.0	9.2	10.3	10.5	8.0	7.8	7.3	7.4	7.2	6.8	6.8	6.7	6.5	6.4	6.4	6.3	6.5	6.7	6.7	6.7	6.3	6.5	6.7	6.7	6.7	6.9	7.2	6.8	6.8	7.0	7.0	7.1	7.1	7.5	7.2	7.7	7.7	8.2	
Totali i kredive të ndërmarrjeve	-5.3	2.3	4.5	1.9	1.1	8.7	11.5	9.7	8.2	6.2	6.2	5.9	6.5	6.5	6.5	5.0	5.8	5.1	5.1	4.1	3.8	3.3	3.3	3.3	4.3	5.9	5.4	5.4	6.6	6.4	5.8	5.8	7.3	8.1	7.5	7.5	10.4		
Totali i depozitave (me para të depozituara), norma vjetore e rritjes ^{/7}	6.1	5.0	12.1	9.0	5.7	7.5	4.9	4.5	5.9	6.9	6.9	8.7	10.7	11.6	11.6	11.2	10.2	9.0	9.0	8.3	7.4	9.1	9.1	9.1	10.3	9.6	9.6	9.6	9.6	8.6	7.6	7.6	7.5	9.0	8.4	8.4	10.7		
Totali i depozitave të popullsisë	2.5	6.1	9.5	7.9	4.6	7.1	5.8	5.9	6.3	8.4	8.4	8.3	8.7	8.8	8.8	8.4	7.0	6.8	6.8	6.8	7.1	7.9	7.9	7.9	7.8	8.6	8.7	8.7	10.8	10.2	8.9	8.9	9.6	12.0	11.2	11.2	11.7		
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	13.4	2.1	9.5	14.6	10.1	11.6	3.7	2.6	5.7	5.9	5.9	12.0	17.8	19.7	19.7	18.9	19.0	15.7	15.7	14.1	9.8	13.2	13.2	13.2	13.2	15.9	12.3	12.2	12.2	8.0	5.0	4.7	4.7	3.9	3.8	4.7	4.67	10.0	
Normat e interesit ^{/8}																																							
Norma e interesit e bonovo të bankës qendore (në fund të muajit/tremujorit/vitit)	3.75	3.25	2.50	2.25	1.50	1.25	4.75	4.75	5.25	5.50	5.50	5.50	5.75	6.00	6.00	6.00	6.15	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.05	6.1	5.80	5.80	
Normat e interesit të huadhenies																																							
në denarë	7.0	6.6	6.1	5.6	5.2	4.9	4.6	5.1	5.1	5.2	5.1	5.2	5.2	5.3	5.2	5.6	5.7	5.7	5.7	5.8	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.8	5.9	5.8		
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzulë)	5.7	5.3	4.9	4.6	4.3	4.1	4.0	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	5.3	5.3	5.2	5.3	5.2	5.2	5.1	5.2	5.1	5.1	5.1	5.0	5.1	5.0	5.0	5.0	5.0	4.9	4.9	4.8	4.9	4.8		
Normat e interesit të depozitave																																							
në denarë	2.5	2.2	2.0	1.9	1.5	1.2	1.1	1.3	1.4	1.5	1.4	1.6	1.6	1.8	1.7	1.9	2.0	2.0	2.0	2.1	2.2	2.3	2.2	1.8	2.2	2.3	2.3	2.2	2.3	2.3	2.4	2.3	2.4	2.4	2.5	2.4	2.6		
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzulë)	1.0	0.9	0.8	0.8	0.6	0.5	0.4	0.6	0.7	0.8	0.7	0.9	0.9	1.0	0.9	1.1	1.2	1.2	1.2	1.3	1.3	1.4	1.3	1.0	1.3	1.3	1.4	1.4	1.4	1.5	1.5	1.4	1.5	1.5	1.6	1.5	1.6		
IV. Treguesit e sektorit të jashtëm																																							
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në milionë euro)	-252.5	-78.3	22.4	-334.7	-318.0	-329.0	-801.3	-26.1	15.5	89.1	78.6	-94.0	21.1	-53.8	-126.7	127.5	25.1	76.5	229.1	-6.1	-1.2	-118.1	-125.4	55.6	-42.0	-81.9	-66.5	-190.4	-50.9	-52.3	-1.7	-104.9	83.4	132.7	47.2	263.3	1.8		
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së)	-2.6	-0.8	0.2	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	-0.2	0.1	0.6	0.5	-																											

Kërkesa e huaj efektive
(ndryshime vjetore në %)




Vlerësimet për **kërkesën e huaj efektive** janë rishikuar pak në rënie për të gjithë periudhën e projeksionit, kryesisht për vitin 2025.....

... që kryesisht është reflektim i vlerësimeve për aktivitet më të dobët ekonomik në Gjermani⁴.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Inflacioni i huaj efektiv
(ndryshime vjetore në %)




Korrigjime minimale në rënie ka edhe në **inflacionin e huaj efektiv...**

...si rezultat i pritjeve për inflacion pak më të ulët të shumica e partnerëve tanë tregtarë të importit.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kursi euro/USD-dollar




Te **kursin euro-dollar amerikan**, pritët zhvlerësim më i vogël i vlerës së dollarit amerikan krahasuar me muajin tetor në të gjithë periudhën e projeksionit...

...që është më së shumti pasqyrim i perspektivës ekonomike të SHBA-ve dhe njoftimeve për vendosjen e tarifave, si dhe i pasigurisë politike në Francë.

⁴ Rënia e projektuar e Gjermanisë prej 0.1% në vitin 2024 dhe rritja prej 0.5% dhe 1.2% përkatësisht në vitet 2025 dhe 2026, kundrejt vlerësimeve për rritje prej 0%, 1.0% dhe 1.3% në tetor.

Nafta "brent"

(mesatarja tremujore, euro/fuçi)




Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-

Sa i përket çmimeve të metaleve dhe produkteve ushqimore, për vitin aktual dhe vitin e ardhshëm janë bërë korrigjime në rënie, ndërsa te çmimet e naftës vlerësimet janë pothuajse të pandryshuara...

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro

(ndryshime vjetore në %)




Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-

...në kushtet e pasigurisë nga tarifat e shpallura në SHBA, të cilat mund të çojnë në rritje të tensioneve gjeopolitike, veçanërisht me Kinën, dhe ulje të kërkesës.

Në vitin 2026 pritet stabilizim i çmimeve të produkteve primare, ngjashëm si në muajin tetor.


Çmimet e grurit dhe misrit në euro

(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Euribor-i njëmuor
(mesatarja tremujore, në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Te **Euribori njëmuor** janë bërë korrigjime minimale në rënie për të gjithë periudhën e projeksionit...

...me pritshmëri për ulje të mëtejshme graduale të normave të interesit nga BQE-ja në periudhën e ardhshme.

Indeksi i stresit financiar




Burimi: "Zyra për Hulumtime Financiare në kuadër të Këshillit për mbikëqyrje të stabilitetit financiar të SHBA'së".

Treguesi për stresin financiar global⁵ vazhdon të tregojë për pak paqëndrueshmëri në tregjet financiare.

⁵ Indeksi ZKF ISF (ang. OFR FSI) e mat stresin financiar të sistemit - çrregullimet në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 variabla të tregut financiar, të agreguara në pesë kategori treguesish: kredia, vlerësimi i kapitalit, financimi, mjetet e sigurta/pa rrezik dhe jostabiliteti. Vlera e indeksit në një ditë të caktuar përfaqëson nivel mesatar të ponderuar të çdo variabli të vëzhguar në treg atë ditë, në raport me vlerën e tij historike, ku indeksi është pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e infalcionit


(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.


Inflacioni dhe çmimet e ushqimeve dhe energjisë

(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p.)



Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja.

Në nëntor të vitit 2024, çmimet e konsumit vendas u rritën me 1,0% në bazë mujore (rënie prej 0,7% në tetor), e cila ishte kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve.

Çmimet e produkteve ushqimore u rritën me 2.2% (rënie prej 2.5% në tetor), kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të mishit, perimeve, bukës dhe drithërave, duke e reflektuar në masë të madhe përfundimin e vlefshmërisë së masës së kontrollit në marzhin e fitimit në tregtinë e një pjese të produkte ushqimore bazë⁶.

Çmimet e lëndëve djegëse shënuan rritje mujore prej 0.3%, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të derivateve të naftës, në kushte të rritjes së çmimit të naftës në bursat botërore të shprehur në euro.


Inflacioni bazë në bazë mujore shënoi rritje të lehtë prej 0.2%, e cila më së shumti erdhi si pasojë e rritjes së çmimeve të duhanit për shkak të rritjes së akcizës, të shërbimeve të hotelarisë dhe aranzhimeve turistike. Nga ana tjetër, ka ulje më të ndjeshme të çmimeve të trafikut ajror, kryesisht nën ndikimin e faktorëve sezonalë.

Norma vjetore e inflacionit në muajin nëntor shënoi përsheptim të moderuar dhe arriti në 4.3% (3.5% në tetor), që vjen si pasojë e rritjes më të fuqishme të çmimeve të komponentit ushqimor me bazë më të ulët krahasuese⁷. Nga ana tjetër, çmimet e lëndëve djegëse vazhdojnë të bien, ndërkohë që inflacioni bazë ngadalësohet.

⁶ Masa ishte në fuqi nga data 24 shtator deri më 31 tetor të vitit 2024, sipas së cilës marzhi më i lartë bruto i fitimit për produktet e përfshira nga masa u përcaktua në shumë totale deri në 10% në tregtinë me shumicë dhe deri në 10% në tregtinë me pakicë për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në zinxhirin tregtar ([lidhje](#)).

⁷ Baza më e ulët krahasuese lidhet me përfundimin e vlefshmërisë së masës për kufizimin e marzhit të fitimit dhe masat e vitit të kaluar për ta kufizuar përkohësisht rritjen e çmimeve.


Diferenca ndërmjet inflacionit vendas dhe inflacionit në Eurozonë



Burimi: Eurostat.

Diferenca në raport me inflacionin në Eurozonë shënoi rritje të moderuar në muajin tetor⁸, në kushtet e përshpejtitimit më të fuqishëm të inflacionit në vend sesa inflacioni në Eurozonë.


Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Pritjet e konsumatorëve⁹ të dhëna në anketat e muajit nëntor për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme vazhdojnë të tregojnë ulje të tyre, por më të dobët krahasuar me pritjet e muajit tetor.

Parashikimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve për inflacionin në 3 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Sa i përket **sektorit të korporatave¹⁰**, në muajin nëntor, pritjet për lëvizjen e çmimeve në periudhën në vijim janë më të ulëta në industrinë përpunuese dhe në ndërtimtari, ndërsa në tregtinë me pakicë dhe në sektorin e shërbimeve janë më të larta.

Norma vjetore e inflacionit të realizuar në muajin nëntor është e ngjashme me normën e parashikuar nga cikli i projeksioneve të tetorit. Nga pikëpamja strukturore, inflacioni bazë është i ngjashëm me atë të projektuar, rënia e çmimeve të lëndëve djegëse është më e dobët se sa pritej, ndërsa komponenti ushqimor ka shënuar rritje pak më të ulët se sa pritej.


Rishikimet e lëvizjeve të pritshme të

⁸ Bazuar në Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit, për të cilin të dhënat e fundit të publikuara për vendin janë për muajin tetor.

⁹ Anketë e Komisionit Evropian për optimizmin e konsumatorit në nëntor të vitit 2024, bazuar në pyetjen për "pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm".

¹⁰ Anketat për trendet e biznesit e Komisionit Evropian në sektorët e industrisë, tregtisë me pakicë, ndërtimtarisë dhe shërbimeve.

Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimeve dhe pijeve joalkolike (indeks, 2015=100)




* Çmimet e huaja efektive të ushqimeve paraqesin shumë e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve.

Burimi: EShS-ja, Eurostat-i dhe llogaritje të BPRMV-së.

supozimeve të jashtme hyrëse në projeksionin e inflacionit për vitin 2024 janë kryesisht në drejtim rënës. Megjithatë, ka ende pasiguri dhe rreziqe të mëdha për dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare.

Paga mesatare e paguar (normat vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

Në shtator të vitit 2024, rritja vjetore e **pagës mesatare nominale neto** u ngadalësua në shumë dhe arriti në 9.8% (12.8% në muajin paraardhës), ...

... ndikuar më së shumti nga ngadalësimi i aktiviteteve të shërbimeve (kur shteroi efekti i transfertave nga rritja me 10% e pagave në sektorin publik në shtator të vitit të kaluar), si dhe në industri dhe ndërtimtari, ndërkohë që rritja e pagave në bujqësi po shpejtohet...


Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve (normat nominale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

... ndërsa të ngjashme janë lëvizjet edhe te **paga reale neto**, rritja e së cilës gjithashtu ngadalësohet në muajin shtator.

Normat e realizuara të rritjes së pagave nominale dhe reale vjetore në tremujorin e tretë të vitit 2024 janë në linjë me projeksionin e tetorit.



Burimi: ESHS-ja dhe parashikime të BPRMV-së.
Të dhënat e parashikuara janë të rregulluara për sezonalitet, por dallimet në seritë për periudhën e realizuar mund të paraqiten edhe si pasojë e rishikimeve të rregullta të ESHS-së.


Në tremujorin e tretë të vitit 2024, rritja reale e PBB-së u përshpejtua lehtësisht në 3% në bazë vjetore (nga 2.8% në tremujorin e mëparshëm)...

...e cila është afër rritjes së parashikuar për këtë tremujor nga cikli i projeksioneve të tetorit.

E parë nga ana e shpenzimeve të PBB-së, rritja në tremujorin e tretë vjen si pasojë e kontributit pozitiv të kërkesës vendase, kryesisht nën ndikimin e rritjes së konsumit personal dhe atij publik, ndërkohë që investimet bruto kanë kontribut minimal pozitiv. Nga ana tjetër, në komponentin e eksportit neto, kontributi është negativ, me nivele thuajse të pandryshuara të importit dhe eksportit krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

E parë nga ana e prodhimit të PBB-së, rritja është e shpërndarë, por gjithsesi në masë të madhe i detyrohet kontributit pozitiv të grupit të veprimtarive "tregti, transport dhe hotelieri". Nga ana tjetër, në industri vërehet sërish kontribut negativ.

Në bazë tremujore, PBB-ja shënon rritje reale prej 0.6%¹¹.



Burimi: ESHS-ja dhe Komisioni Evropian.

Duke e pasur parasysh sasinë e kufizuar të të dhënave të disponueshme, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë i gjendjes së përgjithshme të ekonomisë në tremujorin e katërt të vitit 2024.

Rezultatet e hulumtimeve të anketave për periudhën tetor - nëntor të vitit 2024 tregojnë për perceptime më të favorshme në raport me tremujorin e katërt të vitit 2023, si dhe në raport me tremujorin e mëparshëm¹².


Në tetor, rritja vjetore e qarkullimit në tregtinë totale ngadalësohet lehtë...

...në kushtet e rritjes së tregtisë me shumicë dhe tregtisë së mjeteve motorike dhe rënies së lehtë në tregtinë me pakicë.

¹¹ Sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së.

¹² I referohet anketave të kryera nga Komisioni Evropian për ta matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik është marrë si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorë të veçantë të ekonomisë (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

Veprimtaritë ekonomike (ndryshimet reale vjetore, në %)



* Mesatare e thjeshtë e normave të ndryshimit vjetorë të mënyrave të ndryshme të transportit dhe telekomunikacionit.
Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.

Nga ana tjetër, në muajin tetor, ngushtohet rënia e **prodhimit industrial**...

...e cila në kushtet e kontributeve të mëtejshme negative të sektorit të energjisë dhe të xehetarisë, vjen si pasojë e rritjes së industrisë përpunuese (më së shumti për shkak të prodhimit të pajisjeve elektrike, automjeteve, produkteve kimike dhe farmaceutike si dhe metaleve dhe produkteve metalike).


PRODHIMI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE

	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	tet
<i>ndryshime reale vjetore në %</i>												
Produkti i brendshëm bruto	2.5	4.0	2.0	2.5	0.2	2.0	2.7	3.1	1.9	2.8	3.0	-
Prodhimi industrial	3.5	1.3	-1.8	-3.4	0.1	2.7	-0.7	0.4	-3.0	-7.1	-2.1	-1.1
Punë ndërtimore të realizuara	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	18.2	-
Ndërtim i lartë	-26.6	12.4	-10.0	6.2	12.2	-20.0	-9.8	-18.3	-34.0	-5.3	13.2	-
Ndërtim i ulët	4.2	-13.4	-26.9	-27.2	10.5	-22.6	-7.2	37.1	31.6	48.6	22.7	-
Punë ndërtimore të specializuara	-27.3	-55.3	-21.9	43.5	69.0	10.6	-21.2	11.3	-3.3	98.0	7.0	-
Qarkullimi në tregti - Gjithsej*	9.7	4.0	0.4	-2.7	3.7	-5.2	-6.3	0.2	-3.3	4.0	2.9	1.6
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5	0.9	3.7	-1.2
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	11.0	2.4	-1.3	-3.0	3.8	-3.9	-4.4	2.0	-2.6	6.9	4.0	3.5

*Normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përgjësuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 janë të dhëna preliminare. Të dhënat e PBB-së për vitin 2023 janë preliminare, ndërsa për vitet 2024 janë të vlerësuar.

Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.

Indicative variables for private consumption (real annual growth rates, in %)



Source: SSO and NBRM calculations.

Të dhënat e disponueshme për **konsumin personal** për muajin tetor të vitit 2024 po lëvizin kryesisht në drejtim pozitiv...


... me rritje vjetore të pensioneve¹³, kredive për popullsinë, importit të mallrave për konsum të gjerë, të ardhurave bruto nga TVSH-ja dhe prodhimit vendas të mallrave të konsumit, me përjashtim të tregtisë me pakicë, e cila shënon rënie.

Sa i përket të dhënave me frekuencë të lartë për **investimet bruto** në muajin tetor, ndryshimet vjetore janë në drejtime të ndryshme...

...me rritje të kredive afatgjata për ndërmarrjet, të tatimit mbi fitimin dhe prodhimit vendas të mallrave kapitale, ndërkohë që investimet kapitale shtetërore dhe importet e kapitalit qarkullues shënojnë sërish

¹³ Në tetor të vitit 2024 u bë rritje lineare e pensioneve për 2500 denarë, në vend të harmonizimit të deritanishëm me normën e rritjes gjashtëmujore të koston së jetesës dhe pagës mesatare. Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, rreth 340 mijë pensionistë që e kanë fituar të drejtën e sigurimit pensional deri më 31 gusht, janë të përfshirë në rritjen lineare të pensioneve. Këto ndryshime ligjore parashikojnë edhe një rritje tjetër lineare të pensioneve prej 2.500 denarë në mars të vitit 2025 (me pagesë në prill). Për më shumë informacion shihni në [lidhje](#).

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.

rënie.

Të dhënat për **shkëmbimin në tregtinë e jashtme** në tetor të vitit 2024 tregojnë për rritje të lehtë potenciale të deficitit në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me rënie minimale të eksportit dhe me import të pandryshuar.

Arritjet buxhetore sipas të dhënave fiskale për muajin tetor të vitit 2024 tregojnë për rritje të vogël reale vjetore të **konsumit publik**.


Treguesit kryesorë për tregun e punës¹⁴ edhe në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënojnë lëvizje të moderuara pozitive në bazë vjetore.

Shkalla e punësimit është 46.1% dhe është më e lartë me 0.4 p.p., në kushte të rritjes së numrit të të punësuarve me 0.8%.

Shkalla e papunësisë u ul në 12.3% (ulje me 0.5 p.p.), ndërsa numri i të papunëve u ul me 3.7%.


Nga aspekti i ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e tretë popullsia aktive u rrit me 0,2%, me ulje të njëkohshme të popullsisë joaktive me 0.4%.

¹⁴ Rezultatet e Anketës për fuqinë punëtore (AFP) sipas tremujorëve të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të viteve të tjera, sepse në vitin 2023 është zbatuar Rregullorja e re (BE) nr. 2019/1700 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Statistikë Sociale dhe rregullorja ekzekutive përkatëse e Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për lëmin e fuqisë punëtore, ndërkohë që Rregullorja e mëparshme (KE) nr. 577/98 është shfuqizuar. Aplikimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në anketë, duke filluar me ndryshime në pamjen e pyetësorit, ndryshime në radhën e pyetjeve, ndryshime dhe heqje të pyetjeve ekzistuese dhe shtim të pyetjeve të reja, ndryshime në shtrirjen dhe përkufizimin e punësimit dhe papunësisë. Prandaj, analiza është bërë vetëm në bazë të të dhënave të krahasueshme nga viti 2023 e në vazhdim.



Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja në tetor të vitit 2024 u rrit me 1% në bazë vjetore, në kushtet e rënies së lehtë të eksportit të mallrave dhe njëkohësisht të importit të pandryshuar.

Eksporti i mallrave në tetor të vitit 2024 shënoi rënie të vogël prej 0.4% në bazë vjetore, thuajse tërësisht si pasojë e uljes së eksportit të një pjese të objekteve prodhuese në pronësi të huaj nga industria automobilistike, që është edhe faktori kryesor për arritjet më të ulëta në eksport se sa pritej, në përputhje me projeksionin e tetorit, i plotësuar nga eksporti më i dobët i duhanit.




Importi i mallrave në tetor të vitit 2024 është i pandryshuar në bazë vjetore, me import më të lartë të ushqimeve dhe njëkohësisht me import më të ulët të një pjese të objekteve prodhuese në pronësi të huaj. Aktualisht, realizimet e importit janë më të ulëta se sa pritej me projeksionet e tetorit, me devijime në rënie në importin e lëndëve të para dhe të një pjese të objekteve prodhuese në pronësi të huaj, që lidhen me industrinë e automobilave.

Deficiti tregtar në tetor të vitit 2024 është aktualisht më i ulët se sa pritej sipas projeksionit të tetorit për tremujorin e fundit, por periodha e vlerësimit është shumë e shkurtër për të nxjerrë përfundime më të sakta.


Në tetor të vitit 2024, KREK-ja e defluar me koston e jetesës shënoi mbivlerësim të lehtë prej 0,2% në bazë vjetore, ndërsa indeksi KREK i llogaritur me çmimet e prodhuesve industrialë shënoi mbivlerësim prej 6,8%...

... me mbivlerësim të KNEK-së me 1.5% (kryesisht për shkak të zhvlerësimit të lirës turke në raport me denarin), rënie të koston relative të jetesës dhe rritje të çmimeve relative të produkteve industriale.


Në të njëjtin drejtim janë edhe ndryshimet e indekseve KREK të llogaritura pa produktet primare.




KREK (kursi real efektiv i këmbimit)
normat vjetore të ndryshimit, në %



KREK, pa lëndët e para
normat vjetore të ndryshimit, në %




Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)



Në tremujorin e tretë të vitit 2024, llogaria rrjedhëse arriti suficit prej 263.3 milionë euro, ose 1.8% e PBB-së, që është në përputhje me pritjet e parashikimeve të tetorit...


...me deficit më të ulët në bilancin tregtar, por edhe me flukse hyrëse neto më të ulëta në të ardhurat dytësore, si dhe suficit më të ulët në shërbime dhe deficit më të lartë në të ardhurat primare.

Komponentët e llogarisë financiare
(në milionë euro)




Në tremujorin e tretë të vitit 2024, në llogarinë financiare janë realizuar dalje-neto¹⁵ prej 276.3 milionë euro (ose 1.9% e PBB-së), të cilat janë në përputhje me pritjet sipas projeksionit të tetorit (flukse hyrëse neto më të larta se sa pritej në investime të drejtpërdrejta dhe dalje neto të realizuara në vend të hyrjeve neto të planifikuara në kreditë tregtare).


¹⁵ Sipas metodologjisë së re për përgatitjen e bilancit të pagesave (BPM6), termat hyrje-neto dhe dalje-neto nënkuptojnë përkatësisht krijimin e detyrimeve-neto dhe blerjeve-neto të mjeteve.



Blerja neto në tregun valutor, e realizuar në periudhën tetor-nëntor të vitit 2024, tregon arritje në transfertat private, që janë në përputhje me pritjet për tremujorin e katërt, sipas projeksionit të tetorit.




Rezervat valutore bruto në fund të nëntorit të vitit 2024 arrijnë në 4,920 milionë euro dhe shënojnë rritje në krahasim me fundin e tremujorit të tretë, e cila vjen si pasojë e transaksioneve për llogari të shtetit¹⁶ dhe në një masë më të vogël nga blerja e realizuar gjatë ndërhyrjeve të Bankës Popullore në tregun valutor.




¹⁶ Më datën 17.10.2024, Ministria e Financave ka marrë hua nga Hungarian Export Import Bank PLC, Budapest, në bazë të një marrëveshje kredie në vlerën 500 m.e.

SEKTORI I JASHTËM




Në periudhën tetor - nëntor të vitit 2024, në tregun valutor të bankave është regjistruar blerje neto paksa më e ulët e valutave krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në kushtet e rritjes si të kërkesës ashtu edhe të ofertës për valutë...




...lëvizje të tilla në tregun valutor vijnë si rezultat i rritjes së shitjeve-neto të kompanive në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa njëkohësisht edhe të rritjes së blerjeve-neto nga jorezidentët.

Instrumentet monetare

(gjendja në fund të muajit, në milionë denarë)



(gjendja në fund të vitit, në milionë denarë)



Burimi: BPRMV

Gjendja e instrumenteve monetare në fund të tetorit të vitit 2024 shënon rënie të lehtë krahasuar me muajin e mëparshëm, e cila vjen si pasojë e sasisë më të vogël të mjeteve bankare të vendosura në depozita në dispozicion pranë Bankës Popullore.


Niveli i instrumenteve monetare në fund të muajit tetor është më i ulët krahasuar me nivelin e parashikuar në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024, me aktive neto valutore më të larta të Bankës Popullore dhe me nivel më të lartë të depozitave të shtetit¹⁷, dhe nivel pak më të ulët të mjeteve monetare parësore nga ai i projektuar.

Realizimet te mjetet monetare primare në fund të muajit tetor janë pak nën vlerat e projektuara për fundin e tremujorit të katërt sipas projeksionit të tetorit, me devijim në rënie të parave të gatshme në qarkullim dhe totalit të rezervave të bankave në Bankën Popullore.


¹⁷ Në muajin tetor u realizua hyrja e mjeteve nga marrëveshja e kredisë prej 500 milionë eurosh me Bankën Hungareze të Eksport-Importit dhe këto mjete do të shpenzohen gradualisht dhe do t'i kalojnë vetëqeverisjes lokale dhe kompanive, sipas qëllimit.

Gjithsej depozitat

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




■ Depozitat e sektorëve të tjerë
■ Depozitat në valutë të huaj
■ Depozitat e ndërmarrjeve
■ Depozita, ndryshimet mujore/vjetore, në %

■ Depozitat në denarë
■ Para të depozituara
■ Depozitat e amvisërive
■ Depozita, ndryshimet vjetore, në %


* Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozitat e institucioneve të tjera financiare, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitat e institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërve tek bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve të tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale tek Banka Popullore.
Burimi: BPRMV

Depozitat e individëve

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Burimi: BPRMV.

Totali i depozitave¹⁸ në sistemin financiar në tetor të vitit 2024 shënoi rritje mujore prej 1.8%. Nga aspekti i sektorëve, rritja vjen nga depozitat e të gjithë sektorëve dhe kryesisht nga ndërmarrjet¹⁹, ndërsa nga aspekti valutore, kontributi i depozitave në monedhën vendase (me para depozite) është më i madhi.

Totali i depozitave gjatë tetorit të vitit 2024 shënoi rritje krahasuar me fundin e tremujorit të tretë, që është brenda rritjes së pritur për tremujorin e katërt, sipas projeksionit të tetorit.

Norma vjetore e rritjes së totalit të depozitave në tetor të vitit 2024 është 10.7% dhe është mbi normën e parashikuar për tremujorin e katërt të vitit 2024 prej 7.9%, sipas projeksionit të tetorit.

Në tetor të vitit 2024, **depozitat e amvisërive shënuan rritje të vogël në bazë mujore**, e cila më së shumti vjen si pasojë e rritjes së depozitave në valutë, e më pak e rritjes së depozitave në monedhën vendase (me para depozite), si dhe të rritjes së depozitave afatgjata, nga aspekti i strukturës afatgjatë të maturimit. Në bazë vjetore, depozitat e amvisërive në tetor të vitit 2024 shënuan rritje prej 11.7%.


¹⁸ Të dhënat u referohen depozitave të sektorit joshitetor në banka dhe kursimore, mjetet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë në BPRMV dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në llogaritë në BPRMV. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme:

http://www.nbmv.mk/monetarna_statistika_i_statistika_namati_stapki.nspj.

¹⁹ Rritja e depozitave të kompanive është pjesërisht e lidhur me miratimin e një kredie në një shumë më të madhe për një kompani nga sektori i energjetikës, e cila ka ndikuar edhe në nivelin e depozitave.


Depozitat në denarë dhe në devizë /totali i depozitave të individëve

(pjesëmarrja në fund të muajit, në %)



Në tetor, pjesëmarrja e depozitave në denarë në strukturën valutore të totalit të depozitave të amvisërive është relativisht e qëndrueshme.


(pjesëmarrja në fund të vitit, në %)




* Totali i depozitave vetëm tek bankat dhe kursimoret.
Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë M4

(kontributet në p.p., ndryshime mujore)



(kontributet në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV

Masa monetare e shprehur përmes agregatit më të gjerë monetar M4, në tetor të vitit 2024 shënoi rritje prej 1.6% në bazë mujore, e cila rezulton nga kontributi pozitiv i pothuajse të gjithë përbërësve nga aspekti valutor dhe ai i maturimit (me përjashtim të parave të gatshme në qarkullim, të cila shënojnë ngecje).


Në bazë vjetore, masa monetare në tetor të vitit 2024 u rrit me 10.7%, që është mbi rritjen e pritshme vjetore prej 7.9% për tremujorin e katërt të vitit 2024, sipas projeksionit të tetorit.

Pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në denarë në totalin e M4



Pjesëmarrja e denarit në masën totale monetare M4 në tetor të vitit 2024 është në nivel më të lartë se muaji i mëparshëm dhe është pak nën vlerën e parashikuar për fundin e tremujorit të katërt të vitit.

(të dhënat në fund të vitit, në %)



Burimi: BPRMV


Totali i kredive në muajin tetor shënoi rritje mujore prej 1.8%.

Gjatë tetorit të vitit 2024, totali i kredive shënoi rritje krahasuar me fundin e tremujorit të tretë²⁰, që është pothuajse në nivelin e rritjes së pritshme për tremujorin e katërt të vitit, sipas projeksionit të tetorit.


Norma vjetore e rritjes së totalit të kredive në tetor ishte 9.2%, me rritje vjetore të projektuar për tremujorin e katërt të vitit 2024 prej 7.5%.

Gjithsej kreditë

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Burimi: BPRMV.


²⁰ Rritja është më së shumti për shkak të miratimit të një kredie për një kompani nga sektori i energjetikës.

Kredi të reja të sektorit privat, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes




Shuma e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, në tetor të vitit 2024, ka shënuar rritje të përshpejtuar në bazë vjetore, si rezultat i rritjes së kredive në të dy sektorët (ndërmarrje dhe amvisëri).

Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes



Kredi të reja të amvisërive, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes




Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave totale (të dhënat mujore, në %)



Treguesi për shfrytëzimin e potencialit depozitues të bankave për kreditimin e sektorit privat në muajin tetor është 83.1% dhe i njëjti është mbi vlerën e këtij treguesi të projektuar në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024, sipas projekcionit të tetorit.


(të dhënat vjetore, në %)




Burimi: BPRMV

Normat e interesit të gjithsej depozitave

(të dhëna mujore, në %)



(të dhëna vjetore, në %)




Burimi: BPRMV


Në tetor të vitit 2024, **norma e interesit në totalin e depozitave në valutë²¹** mbeti në nivelin e muajit të mëparshëm, ndërsa **norma e interesit për totalin e depozitave në denarë** shënoi lëvizje të lehtë në rritje, por pa ndryshime të dukshme në diferencën e interesit. Normat e interesit vetëm për depozitat e reja të pranuar në denarë dhe depozitave të reja në valutë shënuan rritje²², por diferenca e interesit mbeti në nivelin e muajit të mëparshëm (0,8 p.p.).

Normat e interesit të depozitave të individëve

(të dhëna mujore, në %)



(të dhëna vjetore, në %)




Burimi: BPRMV

Në tetor, në sektorin "amvisëri" vërehen lëvizje në rritje të normave të interesit si në total ashtu edhe në depozitat e reja në denarë dhe në valutë.

²¹ Në tetor, në sektorin "amvisëri" vërehen lëvizje në rritje të normave të interesit si në total ashtu edhe në depozitat e reja në denarë dhe në valutë: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspj.


²² Për sa i përket normave të interesit të depozitave të reja, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për depozitat e reja të pranuar rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i depozitave të reja (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

Normat e interesit të gjithsej kredive, sipas sektorëve
(të dhëna mujore, në %)



Në tetor të vitit 2024, normat e interesit në **totalin e kredive për ndërmarrjet dhe totalin e kredive për amvisëritë** mbetën të pandryshuara, ndërsa normat e interesit për **kreditë e reja të miratuara²³ për ndërmarrjet dhe kreditë e reja të miratuara për amvisëritë** shënuan rënie krahasuar me muajin e mëparshëm.


(të dhëna vjetore në fund të vitit, në %)



— Norma e interesit të kredive të individëve
— Norma e interesit të kredive të ndërmarrjeve

Burimi: BPRMV.

Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në %) dhe diferenca e tyre (në p.p.)




Diferenca në normat bazë të interesit të Bankës Popullore dhe të Bankës Qendrore Evropiane është e qëndrueshme dhe e pandryshuar.

²³ Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja të miratuara rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

(kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Në tetor të vitit 2024, të hyrat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) shënuan rritje të moderuar vjetore, e cila ishte kryesisht për shkak të rritjes së të hyrave nga kontributet dhe të hyrat jotatimore, si dhe në një masë më të vogël nga të ardhurat e tjera, ndërkohë që të ardhurat tatimore po shënojnë rënie të moderuar. Shpenzimet buxhetore shënuan rritje, si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse (kryesisht nga transfertat më të larta), me rënie të lehtë të njëkohshme të shpenzimeve kapitale.

Në periudhën janar - tetor të vitit 2024, të ardhurat totale buxhetore janë rritur me 11.9%, ndërsa shpenzimet totale buxhetore janë më të larta me 10.3%...

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive,

(Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor




...deficiti i arritur buxhetor në vlerë prej 24.012 milionë denarë paraqet 53,8% të deficitit të planifikuar për vitin 2024 në përputhje me ribalancimin e Buxhetit²⁴...


²⁴ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" Nr.169, datë 15.8.2024.

Financimi i bilancit buxhetor

(në milionë denarë)



... i njëjti financohet nga huamarrja-neto e shtetit në tregjet e brendshme dhe të jashtme, me rritjen e depozitave të shtetit në Bankën Popullore.




* Ndryshimi pozitiv: ulje e depozitave tek BPRMV, ndryshimi negativ: rritje e depozitave tek BPRMV.

Burimi: Ministria e Financave.


Normat e interesit të letrave me vlerë shtetërore

në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Në tetor të vitit 2024, në ankandet e rregullta, u emetuan bono thesari dymbëdhjetë mujore, bono thesari trevjeçar dhe pesëmbëdhjetëvjeçar pa klauzulë valutore, me norma interesi të pandryshuara, përkatësisht 3.8%, 3.95% dhe 5.6%.



Rënie e vogël e **borxhit publik**²⁵ u shënua në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, e ndikuar nga ulja e borxhit të jashtëm publik dhe rritja e vogël e borxhit të brendshëm publik.

Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV-së

²⁵ Borxhi publik përcaktohet me Ligjin për borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019) sipas të cilit ai e përfaqëson shumën e borxhi shtetëror dhe të borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe nga shoqëritë tregtare që janë në tërësi ose kryesisht në pronësi të shtetit ose komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

Shtojca 1: Kategoritë treguese për konsumin personal dhe investimet-bruto

KATEGORITË INDIKATIVE PËR KONSUMIN PRIVAT												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	tet
	ndryshime reale vjetore në %											
Qarkullimi në tregtinë me pakicë*	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5	0.9	3.7	-1.2
Të ardhurat bruto nga TVSh-ja*	29.2	9.5	3.7	-7.7	-15.0	-9.5	-10.7	-1.5	1.6	5.5	4.5	4.8
Importi i mallrave për konsum të gjërë*	-2.8	-1.5	-2.1	-9.9	2.0	4.7	1.4	14.5	15.4	4.1	8.6	1.6
Prodhimi vendor i mallrave të konsumit	2.2	-1.2	3.2	-3.6	6.4	4.9	-7.5	-1.2	-8.5	-7.1	5.4	1.0
Kreditë konsumatore*	-0.5	-5.6	-9.2	-9.3	-6.6	-2.4	0.0	3.1	2.9	3.9	5.1	4.7
Paga mesatare neto*	0.0	-1.7	-4.6	-4.6	-2.8	3.6	6.6	12.8	12.5	9.6	9.0	-
Transfertat private neto*	9.8	24.1	11.8	5.1	11.3	-8.4	-10.4	-1.4	-11.8	-11.3	-5.8	-
Pensionet*	-3.4	-1.0	-10.4	-4.9	-2.5	1.3	9.9	13.4	17.0	10.1	9.5	15.9

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.

KATEGORITË INDIKATIVE PËR INVESTIMET												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	tet
	ndryshimet reale vjetore në %, përveç IHD-ve ku ndryshimet reale janë në milionë denarë											
Importi i mjeteve për punë*	6.9	5.6	10.9	-1.3	-3.9	-1.9	-5.5	3.0	10.9	3.4	-1.8	-6.2
Punë ndërtimore të realizuara**	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	18.2	-
Prodhimi vendor i produkteve kapitale	0.9	3.3	18.6	3.7	6.7	8.2	6.7	17.9	10.6	-2.8	0.9	0.1
Investime kapitale shtetërore*	-16.4	25.0	-47.3	55.6	-6.8	313.0	29.1	-4.0	27.5	-65.8	-25.8	-12.7
Investime të huaja direkte***	9616.2	-6348.6	10624.7	262.4	247.6	-2198.3	-9252.6	-2416.1	8187.8	5037.9	11534.9	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	2.2	-2.2	-6.5	-6.7	-5.0	1.2	3.4	3.9	2.8	4.8	5.8	8.8
Stoqet e produkteve të gatshme	11.5	9.2	11.1	10.5	-3.1	-2.4	-3.8	-0.6	9.3	5.0	-5.9	-

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.

** normat reale të rritjes janë fituar duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve për ndërtimin e banesave të reja.

*** vlerat reale janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar vlerat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2023= 100).

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.